



## URDHRI I STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISË

### KËSHILLI KOMBËTAR

---

#### **VENDIM**

#### **Nr.01 Prot. Dt.20.04.2023**

***“Për mosnjohjen e vendimit Nr.1, dt.06.01.2023, të nënshkruar nga Almiro Gurakuqi në emër të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë dhe njohjen e mbështetjen si të ligjshëm vetëm të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë të zgjedhur me vendimin nr.1, në dt. 29 Janar 2020 nga Asambleja Rajonale e USSH Tiranë”***

Mbështetur në ligjin 127, 02.10.2014, neni 11, pika 2, d dhe Stautin e USSH, neni 18, neni 26, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10, neni 27, pika A,B,C,D,a,b,c,d,e,f,g, neni 30, Këshilli Kombëtar pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi si pikën kryesore të rendit të ditës, problematikën dhe mbarëvajtjen e punës në Këshillin Rajonal të USSH Tiranë, në mbledhjen e dt.20 Prill 2023, ora 11.00, të zhvilluar në ambientet e zyrave qendrore të USSH.

-Këshilli Kombëtar konstaton që z.Gurakuqi ka bërë thirrje 4 herë rradhazi për mbledhje të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë të zgjedhur në mandatin e parë të USSH 2015-2020, në këto data respektive:

- 07.11.2022,
- 16.11.2022,
- 30.11.2022,
- 28.12.2022.

- Këshilli Rajonal i USSH Tiranë e ka refuzuar z.Gurakuqi duke mos iu përgjigjur thirrjes së tij për mbledhje në të 4 rastet.

- Këshilli Kombëtar konstaton që thirrjes për mbledhje i është përgjigjur pozitivisht vetëm 1 anëtar nga 9 anëtarë gjithësej në Këshillin Rajonal të USSH Tiranë.

- Almiro Gurakuqi në një mbledhje të improvizuar të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë, që merrnin pjesë vetëm 2 anëtarë nga 9 anëtarë gjithësej, nxjerr një vendim në emër të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë, për të përjashtuar nga anëtarë të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë 7 anëtarë të tjerë.

Anëtarët e Këshillit Rajonal të USSH Tiranë të përjashtuar sipas Vendimit nr.1, dt.06.01.2023, të nënshkruar nga A. Gurakuqi janë:

1.Dr. Shk.Eneda Petro;

2.Prof.Dr. Rozarka Budina;

3.Dr. Marvin Mersini;

4.Prof.Dr. Ramazan Isufi;

5.Dr. Spartak Sako;

6.Dr. Gjergj Alia;

7.Dr. Shk.Brunilda Koçi.

Këta anëtarë janë shkarkuar me një vendim flagrant, pa asnjë referencë në ligjin 127.02.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e USSH.

Neni 26, 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10, dhe neni 27 pika A,B,C,D,a,b,c,d,e,f,g, të Statutit të USSH, përcaktojnë në mënyrë të detajuar dhe eksplicite procedurat e largimit para kohe të anëtarit të këshillit rajonal si dhe atij të Këshillit Kombëtar. Në asnjë rast dhe në asnjë procedurë nuk legjitimon që Presidenti i Këshillit Rajonal, nuk mund të marrin një vendim personal për largimin e një anëtari të këshillit rajonal të USSH. Vetëm këshilli rajonal i USSH, me vendim të veçantë dhe me shumicë votash, me votim të fshehtë, mund të largojë para kohe një anëtar këshilli.

***Këshilli Kombëtar i USSH vendosi:***

- ***Këshilli Kombëtar nuk e njuh vendimin Nr.1, dt.06.01.2023, të nënshkruar nga Almiro Gurakuqi në emër të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë të zgjedhur në mandatin e parë 2015-2020, për largimin e parakohshëm nga anëtarë të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë të 7 anëtarëve të Këshillit Rajonal të USSH Tiranë.***

1.Dr. Shk.Eneda Petro;

2.Prof.Dr. Rozarka Budina;

3.Dr. Marvin Mersini;

4.Prof.Dr. Ramazan Isufi;

5.Dr. Spartak Sako;

6.Dr. Gjergj Alia;

7.Dr. Shk.Brunilda Koçi.

- ***Arsyetim\**** Në këtë vendim është shkelur procedura e parashikuar në nenin 26, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10, e neni 27, pika A,B,C,D,a,b,c,d,e,f,g, Statutit të USSH, që parashikon largimet parakohe nga anëtar i këshillit rajonal të USSH.

-Në këtë vendim është shkelur procedura e parashikuar në nenin 30 të Statutit të USSH, që parashikon, kur një mbledhje e këshillit rajonal e USSH konsiderohet e ligjshme konform Statutit.

- ***Këshilli Kombëtar i USSH, mbështetur në ligjin 127, 02.10.2014” Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë” e Statutit të USSH, nje dhe mbështet si të ligjshëm vetëm Këshillin Rajonal të USSH të zgjedhur në dt.29 Janar 2020 me kryesi:***

Znj.Enida Petro, Presidente e Këshillit Rajonal të USSH Tiranë;

Z.Gjergj Alia, zv.President i Këshillit Rajonal të USSH Tiranë;

Znj.Orjeta Musabelli, Sekretare e Këshillit Rajonal të USSH Tiranë.

Anetarë: znj.Brunilda Koçi, z.Spartak Sako, z.Grej Malo, znj.Rozarka Budina, z.Hydajet Ponari, znj.Ira Bollo, z.Nikoll Deda.

***Arsyetim\****: Zgjedhja e Këshillit Rajonal të USSH Tiranë është konfirmuar edhe në gjyqin e themelit nga gjykata administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.1000. (80-2021-1001), dt.07.04.2021. Ky vendim i gjyqit të themelit konfirmohet ose mund të kundërshtohet vetëm dhe vetëm, me një vendim të formës së prerë nga gjykata administrative e Apelit Tiranë.

***Vendimet e Këshillit Kombëtar sipas ligjit 127.02.10.2014, neni 11 dhe Statutit të USSH, neni 18, janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjitha strukturat e USSH.***

Vendimi u miratua me këtë numër votash:      20      Pro,      0      Kundra,      0      Abstenim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për Këshillin Kombëtar të U.S.SH.

Presidenti i Këshillit Kombëtar të U.S.SH.

Nikoll Deda